




Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti
Njësia për menaxhimin e Burimeve Njerëzore



Datë:17.01.2024

Nr. Pr.22/24

**RAPORT I VJETOR PUNËS SË
NJËSISË PËR MENAXHIMIN E
BURIMEVE NJERËZORE TË
KOMUNËS SË VITISË
PERIUDHA
01.01.2023-31.12.2023**

Duke u mbështetur në aktivitetet e bazuara në Planin e Punës dhe në legjislacionin aktual, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMMNJ) në Viti paraqet këtë raport pune për periudhën kohore janar – dhjetor **2023**

Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është pasqyrimi i punës njëvjeçare të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vitisë.

Mbështetur në objektivat, qëllimet dhe kompetencën ligjore që ka NJMBNJ-ja me përshkrim, në pika të shkurta paraqesum këtë raport të punës për periudhën janar - dhjetor 2023. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2023 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Zyrtarët Publik, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin e Punës, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën Shtetore, Ligjin e Punës si dhe aktet tjera nënligjore: Statuti i Komunës dhe Vendimi mbi Organizimin e Organeve Komunale dhe aktet tjera nënligjore të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Për vitin 2023, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me kryetarin e Komunës ka hartuar planin e personelit në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria e Administratës Publike - Departamenti i Shërbimit Civil si dhe drejtoritë përkatëse, në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Mbështetur në këtë kemi klasifikuar këto aktivitetet:

Konkurset dhe zhvillimi i procedurave të konkursit

Mbështetur në planin e punës së NJMBNJ-së si dhe duke u mbështetur në kompetencat ligjore, NJMBNJ në pajtim me ligjin dhe aktet normative ka zhvilluar procedurat e konkurseve të brendshme, ngritje në detyrë apo lëvizje paralele. Të gjitha procedurat e konkurseve janë zhvilluar falë bashkëpunimit me drejtoritë përkatëse të Komunës së Vitisë, përkatësisht zyrtarëve të drejtorive përkatëse si dhe falë bashkëpunimit të komisioneve rekrutuese, të cilët kanë qenë të pavarur në punë dhe ju kemi ofruar ndihmë profesionale teknike.

Mbështetur në këtë paraqesum aktivitetet e rekrutimit apo pranimit në punë të punëtorëve na pajtim me planin e punës, duke i radhitur aktivitetet sipas drejtorive komunale:

Drejtoria për Administratë - këto pozita:

Për pozitën asistent administrativ kanë konkuruar 16 kandidatë, ndërsa është pranuar një kandidatë; për pozitën zyrtar ligjor kanë konkuruar 14 kandidatë, është pranuar (1) një kandidat; për pozitën udhëheqës i Sektorit të Shërbimeve të Përbashkëta dhe Teknologji Informatine kanë konkuruar 8 kandidatë dhe është pranuar (1) një kandidat; nga lista pritëse në shërbimin e gjendjes civile është plotësuar me një (1) kandidatë. Për të gjitha këto pozita procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik dhe Rregullorës për Pranim dhe Karrier në Shërbimin Civil.

Drejtoria për Inspeksion, këto pozita:

Për pozitën udhëheqës i Sektorit për Inspektime kanë konkuruar 6 kandidatë, ndërsa është pranuar një kandidat; për pozitën inspektor i ndertimit ka konkuruar (1) një kandidatë dhe është pranuar (1) një candidate; për pozitën inspektor i tregut kanë konkuruar (3) tre kandidatë dhe është pranuar (1) një kandidat. Për të gjitha këto pozita procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik dhe Rregullorës për Pranim dhe Karrier në Shërbimin Civil.

Drejtoria për Arsim, këto pozita:

Duke u mbështetur në Ligjin për Zyrtar Publik si dhe duke u mbështetur në kërkesat e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Viti, NJMBNJ-ja ka shpallur konkurs dhe ka rekrutuar personelin arsimor. Brenda periudhës janar

- dhjetor 2023, NJMBNJ-ja ka realizuar 11 konkurse dhe një konkurs në proces për pozitën mësimdhënës i Matematikës dhe Gjuhës Angleze, dhe një konkurs për pozitën punëtor teknik.

Nga të dhënat që posedojmë, në këto konkurse kanë konkuruar 195 kandidatë, duke përfshirë personel udhëheqës (drejtorë shkollash), personel mësimdhënës (professor/eshë lëndor, mësimdhës lëndor 6-9, mësimdhënës klasor 1-5, edukator/e), staf mbështetës (punëtor teknik). Pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitën e kërkuara në konkurs, janë pranuar në punë 66 persona.

- Mësimdhënës janë pranuar 63;
- Drejtor i shkollës është pranuar (1) drejtor në IAAP “Jonuz Zejnullahu” në Viti; dhe
- Punëtor teknik janë pranuar 2 punëtor teknik.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, këto pozita:

Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – QKMF, në konkursin për mjek të përgjithshëm kanë aplikuar 10 kandidatë, ndërsa janë pranuar 5 kandidatë; për pozitën laborantë pranë QKMF-së kanë aplikuar 5 kandidatë, është pranuar (1) një kandidatë; për pozitën farmacist pranë QKMF-së kanë aplikuar 2 kandidatë, është pranuar (1) një candidate; për pozitën punëtor teknik pranë QKMF-së kanë aplikuar 5 kandidatë, është pranuar (1) një kandidat. Kurse në administratën e DSHMS-së - Qendra për Punë Sociale, nga lista pritëse janë pranuar dy (2) zyrtarë për mirëqenie sociale, për të cilat pozita është shpallur konkursi public, pranim i jashtëm, dhe procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik.

Drejtoria për Financa, këto pozita:

Në Drejtorinë për Financa, në konkursin për zyrtar për regjistrimin e bizneseve kanë aplikuar 9 kandidatë, ndërsa është pranuar 1 kandidat; në Sektorin e Tatimit në Pronë për pozitën zyrtar i tatimit në pronë kanë aplikuar 29 kandidatë, është pranuar (1) një kandidat, për të cilat pozita është shpallur konkursi public, pranim i jashtëm dhe procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik.

Drejtoria për Bujqësi ka këto pozita:

Për pozitën udhëheqës i Sektorit të Pylltarisë, levizje paralele, është përfunduar, por pa kandidat të interesuar; zyrtar të bujqësisë, është zhvilluar procedura e brendshme, nuk ka pasur kandidatë, andaj janë emëruar dy zyrtar nga lista pritëse.

Zyra e Kryetarit të Komunës

Për pozitën udhëheqës i Sektorit të Auditimit kanë konkuruar 7 (shtatë) kandidatë, ndërsa është pranuar një (1) kandidat; për pozitën specialist i auditimit kanë konkuruar 7 (shtatë) kandidatë, ndërsa është pranuar 1 (një) candidate; për pozitën përfaqësues ligjor i Komunës kanë konkuruar (3) tre kandidatë dhe është pranuar (1) një kandidat; për pozitën zyrtar i prokurimit, konkurs i brendshëm, ka konkuruar (1) një kandidat dhe është pranuar (1) një kandidat; për pozitën specialist i përkthimit kanë konkuruar 7 (shtatë) kandidatë, ndërsa është pranuar 1 (një) candidate. Për të gjitha këto pozita procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik dhe Rregullorës për Pranim dhe Karrier në Shërbimin Civil.

Mjetet juridike dhe shqyrtimi i tyre

Duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, e drejta për shfrytëzim të mjeteve juridike në procedurë administrative është parim primar, prandaj mbështetur në këtë, gjatë fazës së rekrutimit si dhe punës së përditshme të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, palët në procedurë administrative kanë shfrytëzuar mjetet juridike. Mbështetur në kompetencë, këtyre mjeteve u janë përgjigjur komisionet e ankesave në afat ligjor:

- Komsioni për nëpunësit e shërbimit publik (Arsim dhe Shëndetësi) ka shqyrtuar 15 ankesa dhe të cilat janë refuzuara si të pabazuara;
- Vendime të shkuarjes në pension dhe lirim nga shërbimi civil të 14 (katërmbdhjetë) zyrtarve të shërbimit civil, përpiluar nga NJMBNJ-ja;
- Vendim për pushime pa pagesë për 1 vit, një shërbyes civil.

Pavarsisht që Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të gjithë kandidatëve ju ka dhënë të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike në procedurë të rekrutimit, ka persona të cilët kanë etiketuar përmes (Kuvendit Komunal), njëra nga këshilltaret komunale ka akuzuar NJMBNJ-në, kinse për shkelje të procedurave të rekrutimit dhe mohimit të punësimit, edhe pse nga NJMBNJ-ja, udhëheqësi i saj ka dhënë përgjegje se, procedurat janë zhvilluar sipas ligjit në fuqi. Kjo u vertetua edhe me hedhjen poshtë të dy kallëzimeve penale si të pabazuara nga ana e Prokurorisë Themelore - Departamenti për Krime të Rënda, të cilat i kishte ushtruar pranë prokurorisë asambleistja A.H. Pas marrjes së njoftimit nga ana e prokurorisë, u konfirmua se, NJMBNJ-ja, udhëheqësi i saj ka zbatuar në përpikëri Ligjin për Zyrtar Publik.

Gjithashtu janë kryer edhe vendime, shkresa të ndryshme rutinë që janë natyrë e punës administrative dhe zyrtare.

Vlerësimi i performancës (rezultate në punë) së zyrtarëve publik

Në kordinim me drejtoritë përkatëse, për të gjithë zyrtarët publik është bërë vlerësimi i rezultateve të punës konform rregullave që janë në fuqi. Ky proces është bërë duke rrespektuar rregullat, ku mbikëqyerësit të drejtpërdrejt kanë vlerësuar rezultatet në punë të zyrtarëve të tyre, në kuadër të departamentit përkatës. Kurse NJMBNJ-ja ka monitoruar dhe ka sistemuar vlerësimet në dosjet e tyre personale.

Gjatë vitit 2023 vëmendje ju është kushtuar **nevojave për trajnimin** e nëpunësve civil ekzistues dhe nëpunësve të rinj. Në bashkëpunim me IKAP-in janë mundësuar trajnime për profilet përkatëse tek nëpunësit ekzistues dhe trajnimi hyrës për nëpunës të rinj.

Dosjet Individuale elektronike për nëpunës të shërbimit publik dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës janë përpunuar gjatë vitit 2023, duke u ngarkuar dokumente relevante të secilit nëpunës, ndërsa dosjet individuale elektronike për shërbimin civil janë përpunuar dhe plotësuar edhe gjatë vitit 2023.

Njësia për Menaxhimin të Burimeve Njerëzore ka përpiluar planin e personelit për vitin 2024 përmes SIMBNJ/HRMIS. I njëjti është dërguar për aprovim tek udhëheqësi më i lartë administrativ për aprovim. Pas aprovimit i njëjti është dërguar në DMZP në Prishtinë.

Ku raport është punuar në përputhje me nenin 16, paragrafi 4 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr.08/L197.

Viti, më 17.01.2024

Udhëheqësi i NjMBNJ

Hysen Ymeri



Kryetari i Komunës

Sokol Haliti

